



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 10/2018 regjistër (JR)
Datë 31.7.2018

Nr. 12 i vendimit
Datë 17.12.2018

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

| | |
|-----------------|------------------------|
| Kryesues | Ardian Hajdari |
| Relator | Luan Daci |
| Anëtare | Albana Shtylla |
| Anëtare | Natasha Mulaj |
| Anëtare | Rezarta Schuetz |

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 17.12.2018, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Hans Peter Kijlstra, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket ankimit:

ANKUES: Komisioneri Publik Darjel Sina

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 24, datë 13.6.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Bashkim Dedja, gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, përfaqësuar me prokurë nga Avokat Maksim Haxhia.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT,

pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), dëgjoi kërkimet e palëve: të subjektit të rivlerësimit Bashkim Dedja dhe të përfaqësuesit të tij, Avokat Maksim Haxhia, të Komisionerit Publik, i cili përfundimisht kërkoi sipas ankimit; të Subjektit të Rivlerësimit, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 24, datë 13.6.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Luan Daci, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 24, datë 13.6.2018, ka vendosur:
 - i) Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Bashkim Dedja, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese.
 - ii) Vendimi i arsyetuar, me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
 - iii) Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim Kolegji i Apelit) nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga dita e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- 1.1. Komisioni ka arritur në këtë vendim sipas konkluzioneve në vijim. i) Në lidhje me pasurinë e llojit “apartament”, me sipërfaqe 98 m², në Tiranë, nga Komisioni konstatohet se ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar (*vetting*) dhe deklaratimet ndër vite lidhur me pagesën e kryer për blerjen e këtij apartamenti, por subjekti i ka sqaruar këto pasaktësi dhe, referuar kohës kur kjo pasuri është blerë, vitit 1997, çdokush sipas Komisionit mund të gjendet në situata të pamundësisë për të qenë i saktë në deklaratime, megjithatë sqarimet e dhëna treguan se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për të blerë këtë pasuri të paluajtshme dhe se pasaktësitë nuk kanë qenë të qëllimshme. Komisioni gjithashtu ka konstatuar se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe hetimi i kryer nga vetë Komisioni lidhur me këtë pronë përputhen me të dhënat e administruara. Objekti i hetimit sipas Komisionit është kontrolli i pasurive të deklaruara gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të subjektit të rivlerësuar dhe jo kontrolli i deklaratave të pasurisë të bëra gjatë viteve, gjatë kryerjes së detyrës dhe se mospërfshirja e një burimi që ka ekzistuar më parë, por që nuk ekziston më në momentin e deklaratimit në formularin e *vetting*-ut, i cili ka për objekt vetëm deklarin e pasurive ekzistuese, çmohet se nuk përbën shkak për fshehje të pasurisë apo deklarim të pasaktë. Sipas Komisionit, duke qenë një detyrim kontraktor si të gjitha detyrimet e tjera, në bazë të nenit 473 të Kodit Civil, ky konfirmim i kreditorit me shkrim, dhënë në mënyrë vullnetare, me anë të të cilit pranohet ekzekutimi i detyrimit, shkarkon palën debitore

nga detyrimi për të provuar pagesat e mëparshme të parashikuara në kuadër të ekzekutimit të detyrimeve, që kanë ardhur si rezultat i kontratës së sipërmarrjes. ii) Në lidhje me pasurinë e llojit “apartament”, me sipërfaqe 146,14 m², në Tiranë, nga Komisioni konstatohet se përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara, se personi tjetër i lidhur me të, kunati E.C., i cili e ka mbështetur në këtë blerje duke i dhënë hua, ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të dhënë huan në shumën 10.000 euro, dhe se vëllai i subjektit të rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të dhënë huan në shumën 15.000 euro. Komisioni ka vlerësuar se, sipas nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, dhe jo mënyra e kryerjes së pagesave dhe mënyra e ekzekutimit të detyrimit. iii) Në lidhje me pasurinë e llojit “apartament”, me sipërfaqe 60 m², në Golem, nga Komisioni konstatohet se rezultojnë që subjekti i rivlerësimit ka qenë i saktë dhe i vërtetë në deklarimin e tij dhe që nuk kishte dyshime se ai mund të ketë bërë fshehje pasurie dhe që vëllai M.D. ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë këtë banesë.

II. Shkaqet e ankimit

2. Komisioneri Publik, me ankimin nr. 266/5 prot., datë 26.7.2018, mbi bazën e rekomandimit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, ka apeluar vendimin nr. 24, datë 13.6.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke paraqitur shkaqe që lidhen me kontrollin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit.
- 2.1. Me parashtrimet e paraqitura në seancë gjyqësore publike, Komisioneri Publik ka shpjeguar se, referuar gjendjes së akteve në dosje, ankimi ushtrohet për kriterin dhe nivelin e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, kontroll për të cilin pretendon se nuk ka qenë i bazuar në prova të besueshme, në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera.

A. Shkaqet mbi vlerësimin e pasurisë

3. Pasuria e paluajtshme e llojit “apartament”, me sipërfaqe 98 m², nr. {***},, zk {***},, ndodhur në rrugën {***} Tiranë, fillimisht është përfshirë në deklaratën vjetore të vitit 2003, me burim krijimi “të ardhurat nga paga dhe të vëllait M.D., në emigracion nga viti 1993, me pjesë takuese 50% me 50%”; ndërsa, në deklaratën për procesin e rivlerësimit (*vetting*) të vitit 2017, është deklaruar me burim krijimi “kursimet dhe të ardhurat”, me pjesë takuese 100% të subjektit të rivlerësimit.
- 3.1. Komisioneri Publik vlerëson se mospërputhjet e deklarimeve për këtë pasuri çojnë në përfundimin e deklaratimit të pasaktë. Komisioneri Publik ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se do ta merrte së bashku me të vëllanë apartamentin, kjo pasi në vitin 1997 ishin ende në një trung familjar dhe ishin të pamartuar; qëllimi fillestar ishte pagimi i pasurisë së mësipërme me kontributin e të dyve, pavarësisht faktit që kontrata e sipërmarrjes ishte bërë vetëm në emër të subjektit të rivlerësimit në vitin 1997, vit në të cilin është bërë edhe pagimi i kështit të parë të çmimit

apartamentit. Komisioneri Publik gjithashtu ka konstatuar se më vonë, vëllai i subjektit të rivlerësimit nuk kishte më interes të kthehej në Shqipëri dhe të ishte pjesëtar i kësaj banese, pasi mori dokumentet e qëndrimit në Greqi, u integrua atje dhe krijoi familje. Pra, konstatohet se gjithçka është bërë me mirëkuptim dhe nuk ka dokumente për këtë, për shkak të lidhjes së ngushtë që subjekti i rivlerësimit pretendon se ka me të vëllanë dhe, si rrjedhojë, kontrata e shitjes është në emër të subjektit të rivlerësimit dhe po ashtu edhe vërtetimi i pronësisë.

- 3.2. Bazuar në parashikimet e Aneksit të Kushtetutës, neni D, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, neni 32, pika 1, si dhe të udhëzimit të ILDKPKI-së nr. 4095, datë 10.10.2016, Komisioneri Publik argumenton se subjekti i rivlerësimit duhet të depozitonte dokumentacion justifikues edhe në emër të personit të lidhur dhe se subjekti i rivlerësimit në deklarimin e kësaj pasurie duhet të jepte një kronologji të detajuar të krijimit të saj, në të cilën të përshkruhej kontributi i vëllait si burim krijimi, sasia e kontributit të tij, si dhe heqja dorë e tij nga kjo pasuri. Këto shpjegime, vijon Komisioneri Publik, do t'i shërbenin përmbushjes me korrektësi të detyrimeve ligjore të deklarimit të saktë dhe do të kursenin shpenzimet administrative gjatë procesit hetimor. Komisioneri Publik vlerëson se arsyeja e stabilizimit në shtetin grek si shkak për heqjen dorë nga personi i lidhur, vëllai i tij, nga pasuria, nuk është e bazuar në prova, pasi nga dokumentacioni i administruar në fashikullin e Komisionit rezultojnë konfirmime të zyrave vendore të pasurive të paluajtshme Durrës dhe Tiranë, sipas të cilave vëllai i tij ka investuar në pasuri të paluajtshme në Shqipëri pas vitit 1998. Investimet e bëra prej tij, sipas Komisionerit Publik, tregojnë se për arsye të stabilizimit në shtetin grek, ka humbur interesin për të vijuar me investime të mëtejshme në Shqipëri. Gjithashtu, deklarimi se qëndrimi i rregullt filloi pas vitit 1998, bie në kundërshtim me vërtetimin për periudhën kohore të qëndrimit të ligjshëm, i paraqitur si provë prej subjektit të rivlerësimit, në të cilin dëshmohet viti 2002.
- 3.3. Komisioneri Publik konstaton se në fashikullin e Komisionit nuk rezulton ndonjë e dhënë për kontributet respektive të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, vëllait, për këstet e shlyera. Duke iu referuar dokumentacionit, Komisioneri Publik konstaton se ndërtimi i pallatit në të cilin ndodhet apartamenti i blerë ka përfunduar në muajin korrik 1997, muaj në të cilin është lëshuar procesverbali i kolaudimit dhe, sipas kontratës individuale të porosisë, vlerëson se duhet të jetë likuiduar edhe kësti i tretë, i parashikuar me fillimin e punimeve të rifiniturës. Sipas Komisionerit Publik, shuma totale e shlyer në muajin korrik 1997 për këtë apartament duhej të ishte në vlerën prej rreth 17.000 USD (90% e vlerës së apartamentit). Komisioneri Publik konstaton gjithashtu se subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e dhëna ka mbajtur qëndrimin se pagesa e kësteve është bërë ndaj shoqërisë ndërtuese {***} SHPK në kohë të ndryshme, sepse përndryshe nuk lidhej kontrata e shitjes, por për këto pagesa subjekti i rivlerësimit nuk disponon vërtetimet përkatëse.
- 3.4. Sa i përket mundësisë financiare për pagimin e këstit të parë më datë 20.1.1997, Komisioneri Publik ka marrë në analizë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, sipas të cilave në librezën e tij të punës janë pasqyruar të ardhura që nuk janë llogaritur nga Komisioni dhe se shuma totale e të ardhurave personale rezulton të ketë qenë në vlerën 650.000 lekë, shumë që e tejkalon këstin prej 588.000 lekësh, të përcaktuar në kontratë për vitin 1997. Ndërsa për mundësinë financiare të personit të lidhur, vëllait M.D., për të kontribuar në këtë pasuri, Komisioneri Publik ka marrë në

analizë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit sipas të cilave, në periudhën kur është paguar kësti i parë i apartamentit, vëllai i tij jo vetëm ka qenë emigrant në Greqi (fakt që vërtetohet nga Njësia Administrative Dibër), por ka qenë edhe ndër emigrantët e parë që ka marrë leje qëndrimi dhe punësimi në Greqi, por në vitet 1993-1998 ka qenë me qëndrim të paligjshëm në shtetin grek, ashtu sikurse mijëra shqiptarë në Evropë.

- 3.5. Në vlerësim të Komisionerit Publik, sipas dokumentacionit ligjor të administruar deri në korrik 1997, shumta e paguar për apartamentin, sipas kontratës individuale të porosisë, duhet të ishte rreth 17.000 USD dhe, në mungesë të të dhënave mbi kohën e kryerjes së pagesave, për hir të analizës financiare, e shih të përqendrohet në mundësinë financiare për pagimin e këstit të parë që përkon me datën 20.1.1997.
- 3.6. Pas përfundimit të analizës financiare, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme që të paguante këstin e parë të apartamentit, në shumën 588.000 lekë, pasi totali i të ardhurave të ligjshme të subjektit për periudhën 1994-1996, është në vlerën 510.223 lekë.
- 3.7. Ka mospërputhje, sipas Komisionerit Publik, në deklaratimet e bëra ndër vite, pasi në deklaratën vjetore të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit deklaroi që ka detyrim ndaj shoqërisë ndërtuese {***} SHPK, shumën 200.000 lekë, ndërsa në deklaratën vjetore të vitit 2005 subjekti ka deklaruar detyrimin 2.600 USD, detyrim i cili bazuar në deklaratat vjetore në vazhdim, nuk figuron të jetë shlyer. Gjithashtu, sipas Komisionerit Publik, në deklaratën vjetore të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën e apartamentit në shumën 1.700.000 lekë, ndërsa referuar kontratës kjo vlerë është 1.812.020 lekë. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit është në pamjaftueshmëri financiare për blerjen e kësaj pasurie, si rrjedhojë ka kryer deklaratim të pasaktë për pasurinë, si dhe për detyrimet financiare në deklaratën vjetore të vitit 2003.
- 3.8. Për sa i përket ligjshmërisë së të ardhurave të personit të lidhur, vëllait M.D., Komisioneri Publik vlerëson se, në bazë të parimit të rezidencës, ky i fundit nuk ka qenë rezident në shtetin grek për qëllime tatimore. Të ardhura të ligjshme të vëllait të subjektit të rivlerësimit, sipas Komisionerit Publik, do të konsideroheshin të ardhurat për të cilat vëllai i tij ka paguar detyrimet tatimore në shtetin ku ka punuar. Pra, Komisioneri Publik vlerëson se nuk janë kushtet kur duhet të bëhet interpretim i të ardhurave të ligjshme të personit të lidhur mbi bazën se sa ka deklaruar në shtetin shqiptar apo a kishte detyrimin të deklaronte në shtetin shqiptar.
- 3.9. Komisioneri Publik, në kundërshtim me vlerësimin e Komisionit se dhënia e parave nga një person te tjetri në legjislacionin shqiptar tatimor nuk gjen asnjë përcaktim si realizim të ardhurash të tatueshme, argumenton se kjo është në kundërshtim me ligjin nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, ku përcaktohet se si burim të ardhurash do të jenë “të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e parashikuara në këtë nen” (neni 4/i) dhe se për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merren si të ardhura të tatueshme “të ardhurat nga [...] huaja” (neni 8, pika 1/d). Deklarata noteriale e shtetasit grek E.V., punëdhënësit të personit të lidhur, vihet në dyshim nga Komisioneri Publik për shkak të referimit të punësimit të personit të lidhur nga viti 1998, ndërkohë

që qëndrimi i rregullt i tij ka filluar në vitin 2002. Gjithashtu, sipas Komisionerit Publik, meqenëse është shqyrtuar mundësia financiare e personit të lidhur, vëllait, për periudhën deri në vitin 1997, e cila është në interes të trajtimit të kësaj pasurie, rezulton se në dosje nuk ka dokumente që të japin informacion mbi të ardhurat e minimumit jetik në atë periudhë në shtetin grek apo të ardhurat mesatare për shtetasit grekë, bazuar në të dhënat statistikore të shtetit fqinj për atë periudhë, të dhëna që do t'i shërbenin analizës financiare për të ardhurat e ligjshme të personit të lidhur, vëllait. Komisioneri Publik vlerëson se personi i lidhur, vëllai M.D., është në pamjaftueshmëri financiare për blerjen e kësaj pasurie, si rrjedhojë subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë për kontributin e vëllait në blerjen e kësaj pasurie.

3.10. Në përfundim të parashtrimeve, sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte burimin e të ardhurave dhe, si rrjedhojë, fuqinë blerëse për këtë pasuri, si dhe të provonte kontributin në vlerë monetare të të vëllait, M.D., dhe kontributin në vlerë monetare të vetë atij, me qëllim për të mundësuar kështu kontrollin e plotë dhe të saktë të krijimit të kësaj pasurie. Për këto arsye, nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë. Gjithashtu, sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit aktualisht e posedon këtë apartament, por deklaron se nuk jeton në të apo ta ketë lëshuar me qira, pra mbetet i paqartë përdorimi i kësaj pasurie të paluajtshme, si dhe shkalla e gjenerimit të të ardhurave prej saj.

4. Pasuria e paluajtshme e llojit “apartament”, me sipërfaqe 146 m² dhe “garazh” me sipërfaqe 15,25 m², respektivisht me nr. pas. {***} dhe {***}, zk {***}, ndodhur në rrugën {***}, Tiranë, fillimisht është përfshirë në deklaratën vjetore të vitit 2013, me burim krijimi të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, kredi bankare nga Banka Kombëtare Tregtare (BKT), hua pa interes nga E.C., kunati, vëllai i bashkëshortes, hua pa interes nga M.D., vëllai i subjektit të rivlerësimit, me pjesë të ndarë në përqindje me bashkëshorten, kurse në vijim në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (*vetting*) me të njëjtin përshkrim.

4.1. Komisioneri Publik, në lidhje me huan pa interes nga kunati, ka marrë në vlerësim shpjegimet e subjektit të rivlerësimit sipas të cilave: kunati i tij, i cili nga viti 2002 e në vazhdim jeton e punon në Itali, për një periudhë kohore nuk ka pasur dokumente të rregullta qëndrimi dhe, për pasojë, nuk ka mundur të sigurojë kontrata punësimi; ai është paguar nga punëdhënësi me para në dorë për punën që ka kryer; edhe pasi është pajisur me leje qëndrimi, kunati i tij ka vazhduar të paguhet pjesërisht me para në dorë dhe pjesërisht nëpërmjet pagesave bankare. Për të provuar marrëdhënien e huas, Komisioneri Publik ka marrë në vlerësim deklaratën noteriale datë 26.3.2014, bashkëngjitur deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit (*vetting*), me palë subjektin e rivlerësimit dhe kunatin e tij, nga ku rezulton se “E.C. i ka dhënë hua më datë 10.10.2013 kunatit të tij, hua pa interes, për një periudhë pa afat shumë prej 10000 euro (dhjetë mijë euro)”. Gjithashtu, Komisioneri Publik ka marrë në vlerësim konstatimin e Komisionit se më datë 10.10.2013, datë kur është bërë deklarata noteriale, E.C. nuk ka qenë në Shqipëri, dhe se subjekti i rivlerësimit këtë konstatim dhe faktin e krijimit dhe të sjelljes së të ardhurave e ka konfirmuar nëpërmjet deklaratës tjetër noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.4.2018, të P.C. (babai i

E.C.), sipas së cilës ky i fundit i ka dorëzuar subjektit të rivlerësimit shumën e marrë hua pa interes nga kunati.

- 4.2. Komisioneri Publik, përkundër arsyetimit të Komisionit se parashikimi kushtetues për të ardhurat e ligjshme që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, nuk gjen zbatim për personin tjetër të lidhur, kunatin, pasi ai nuk ka realizuar të ardhura në Republikën e Shqipërisë dhe nuk ka qenë subjekt i deklarimit të pasurisë, vlerëson se nuk qëndron, pasi parimet që udhëheqin shumicën e legjislacioneve tatimore janë të njëjta dhe një ndër këto parime është edhe ai i “rezidencës”. Sipas këtij të fundit, të ardhurat nga punësimi taten në vendin e burimit, ku ushtrohet puna. Në këtë kuptim, sipas Komisionerit Publik, personi tjetër i lidhur duhet të dëshmojë kapacitetin financiar për të dhënë shumën e huas, kapaciteti i cili nuk mund të rezultojë nga vlerësimet e llojit se “mund të kursente të paktën shumën prej 1000 eurosh për çdo vit, duke i dhënë ato hua pa kundërshtëpërblim”, por duhet të ishte bazuar në një analizë financiare. Po sipas Komisionerit Publik, dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të ardhurat e realizuara nga personi tjetër i lidhur, kunati, janë deklarata të punëdhënësve në Itali dhe jo nga autoritetet kompetente italiane të cilat dëshmojnë pagimin e taksave në shtetin italian.
- 4.3. Komisioneri Publik ka marrë në vlerësim shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se, për huan pa interes të marrë nga vëllai, i cili është emigrant ekonomik në Greqi nga viti 1993 e në vazhdim, dhe për të provuar marrëdhënien e huas i ka bashkëngjitur deklaratën së pasurisë për procesin e rivlerësimit *vetting*, deklaratën noteriale të datës 25.3.2014, me palë subjektin e rivlerësimit dhe vëllanë e tij ku deklarohet se M.D. i ka dhënë hua më datë 22.8.2013 vëllait të tij pa interes, për një periudhë pa afat, shumën prej 15.000 eurosh.
- 4.4. Komisioneri Publik, ka parashtruar të njëjtat pretendime siç janë përshkruar në pikën 4.2 më sipër edhe për personin tjetër të lidhur, M.D. Ky i fundit, personi tjetër i lidhur, M.D., duhet të dëshmonte kapacitetin financiar të tij për të dhënë shumën e huas, kapaciteti i cili nuk mund të rezultonte nga vlerësimet e llojit se “mund të kursente të paktën shumën prej 1000 eurosh për çdo vit, duke i dhënë ato hua pa kundërshtëpërblim”, por bazuar në një analizë financiare. Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të ardhurat e realizuara nga personi tjetër i lidhur, M.D., përbëhet nga deklaratat e një shtetasi grek në cilësinë e punëdhënësit dhe vërtetimi për qëndrimin e ligjshëm në shtetin grek. Këto dokumente, sipas Komisionerit Publik, bien ndesh me njëra-tjetrën në elementin kohë, pasi bazuar në vërtetimin e lëshuar nga organi kompetent i shtetit grek, qëndrimi i ligjshëm fillon në vitin 2002, ndërkohë që sipas punëdhënësit grek personi tjetër i lidhur ka filluar punë në vitin 1998. Për të vërtetuar pagesat e deklaruara nga punëdhënësi grek, sipas Komisionerit Publik, nuk është paraqitur dokument zyrtar që do t'i provonte si të ligjshme dhe nuk mund të shërbejë si i tillë një deklaram i një qytetari si provë për ligjshmërinë e të ardhurave. Komisioneri Publik vlerëson se këto të ardhura nuk mund të konsiderohen të ligjshme, pasi nuk janë lëshuar nga autoritetet zyrtare, të cilat mund të vërtetojnë pagimin e taksave në Greqi. Po ashtu Komisioneri Publik konstaton se nga dokumentacioni i administruar në fashikullin e Komisionit, rezulton se personi tjetër i lidhur, vëllai, ka kontribuar në disa pasuri në Shqipëri, herë veçmas dhe herë në pronësi me vëllezërit, 10.355.540 lekë. Për më

tepër, rezulton se në vitin 2014, vëllai M.D. ka marrë kredi pranë Alpha Bank në shumën 25.000 euro, ndërkohë që i kishte dhënë subjektit të rivlerësimit hua pa interes shumën 15.000 euro.

- 4.5. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion që të mund të vërtetonte mundësinë e aftësisë pagueuse të personave të tjerë të lidhur, si dhe paraqiti rrethana dhe fakte kontradiktore dhe të pasakta në përfundim të parashtrimeve. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të justifikojë me të ardhura të ligjshme burimin e krijimit të kësaj pasurie.
5. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament”, nr. {***}, me sipërfaqe 60 m², vol. {***}, f. {***}, zk {***} në Kryemëdhenj, Golem, pronar L.D., për të cilën subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit të Komisionit, ka deklaruar: “[...] kam përdorur herë pas here me ditë, një apartament dhomë e kuzhinë në pronësi të L.D., të ndodhur te {***}, në Golem, Kavajë”, rezulton se nuk e ka përfshirë këtë fakt në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (*vetting*).
- 5.1. Komisioneri Publik ka marrë në vlerësim shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, se ai nuk ka deklaruar që ka një apartament në përdorim, por ka thënë se “për të qenë sa më transparent, e kam përdorur ndonjëherë me ditë, gjatë pushimeve të verës”, dhe për këtë arsye kjo shprehje nuk nënkupton se ka pasur një marrëdhënie juridike të tillë, për përdorimin e sendit, sipas dispozitave përkatëse të Kodit Civil. Sipas Komisionerit Publik, Komisioni ka justifikuar pa të drejtë dhe në kundërshtim me ligjin dhe faktet, mosdeklarimin nga ana e subjektit të rivlerësimit të një të drejte reale që faktikisht ai e ka mbi sendin, bazuar në kontratën e furnizimit me energji elektrike me OSHEE, datë 12.11.2004, të lidhur nga subjekti i rivlerësimit për një apartament në Golem.
- 5.2. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se “çelja e librezës së energjisë elektrike në emrin e subjektit të rivlerësimit është bërë meqë punonte në Durrës dhe vëllai banonte në Dibër”, apo se “e ka përdorur ndonjëherë”, janë bërë me qëllimin e të moskualifikuarit si përdorim të së drejtës reale që kishte mbi banesën vetë subjekti i rivlerësimit. Ajo çfarë nuk ka qenë e lejueshme, sipas Komisionerit Publik, është lidhja e kontratës së furnizimit me një person i cili nuk ka qenë zotërues i sendit, dhe kjo është ajo mbi të cilën Komisioni duhet të kishte hetuar më thellë. Duke vijuar, Komisioneri Publik shprehet se bazuar në vendimin nr. 17, datë 19.12.2001, të Këshillit Drejtues të ERE-s “Mbi miratimin e udhëzimit mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj”, në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës, cilësohen si përdorues të energjisë elektrike personat fizikë dhe juridikë, zotërues të objektit, ku janë vendosur pajisje që punojnë me energji elektrike dhe janë apo duan të lidhen në rrjetin elektrik. Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se fakti i përdorimit sipas nevojave të familjes dhe zotërimit të librezës së energjisë elektrike për apartamentin me vendndodhje në Golem, në emër të subjektit të rivlerësimit, pavarësisht mungesës të pronësisë së tij mbi këtë apartament, e kualifikon subjektin si përdorues të sendit në kuptim të nenit D të Kushtetutës dhe të drejtën reale si objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (*vetting*) dhe, për rrjedhim, kualifikon pronarin e këtij apartamenti si person tjetër të lidhur, duke e ngarkuar me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

- 5.3. Komisioneri Publik vlerëson si të ardhura të ligjshme të personit tjetër të lidhur, L.D., shumën prej 1268.747 lekësh dhe, për këtë arsye, ky i fundit rezulton me të ardhura të pamjaftueshme për të justifikuar pasuritë. Si rrjedhojë, lidhur me pasurinë e mësipërme, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm dhe personi tjetër i lidhur nuk ka arritur të justifikojë bindshëm të ardhurat e ligjshme për investimin e bërë.
- 5.4. Në përfundim të parashtrimeve, sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar plotësisht dhe saktësisht pasuritë në funksion të kontrollit të kriterit të pasurisë, nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm financiar të vëllait të tij, si person tjetër i lidhur për të blerë këtë pasuri, si dhe është përpjekur të fshehë pasuri në pronësi, posedim ose përdorim të tij.
6. Për sa u përket likuiditeteve, sipas analizës së kryer nga Komisioneri Publik, kanë rezultuar vite në të cilat subjekti i rivlerësimit nuk mbulonte me të ardhura të ligjshme shpenzimet e kryera, likuiditet e deklaruar dhe pasuritë e krijuara. Sipas kësaj analize, në vitin 2011, subjekti i rivlerësimit rezulton me një diferencë të pambuluar në shumën 537.250 lekë, dhe në këtë vit subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime apo gjendje *cash* 9.500 euro, ose e konvertuar 1.319.935 lekë, kurse gjendja në bankë në fund të vitit ka qenë 2.361.282 lekë (shtuar 1.370.024 lekë). Kursimet e shtuara në bankë dhe në banesë të subjektit të rivlerësimit për këtë vit, të konvertuara në lekë, janë 2.689.958 lekë (9.500 euro dhe 1.370.024 lekë). Në vitin 2013, ka një diferencë të pambuluar prej 3.516.645 lekësh. Në këtë vit subjekti ka blerë apartament + garazh me vlerë 25.236.947 lekë. Për këtë apartament, subjekti ka deklaruar se ka marrë kredi pranë BKT në shumën 16.800.000 lekë, ndërsa diferencën pretendon se e ka paguar me huan e marrë nga kunati dhe i vëllai, si dhe nga kursimet familjare. Por, nga analiza financiare është arritur në përfundimin se vëllai dhe kunati nuk kanë të ardhura të ligjshme të mjaftueshme dhe të vërtetuara me dokumente ligjore për të mbuluar shumën e pretenduar si hua. Pra, në këtë vit, diferenca e pambuluar përfaqëson huan prej 25.000 eurosh marrë borxh dhe e konsideruar si e ardhur jo e ligjshme e personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit. Në vitin 2014, rezulton një diferencë e pambuluar prej 481.000 lekësh. Në këtë vit subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë gjendje në bankë shumën 454.796 lekë dhe kanë kryer pagesa për shkollim, mobilim, këst kredie dhe shpenzime të nevojshme jetësore, të cilat nuk i mbulojnë me të ardhura të ligjshme.
7. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri Publik kërkon që Kolegji i Apelit të marrë në shqyrtim shkaqet e këtij ankimi dhe, mbështetur në provat e mbledhura, në zbatim të gurmës “b” të nenit 66 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 24, datë 13.6.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Bashkim Dedja.

B. Prapësimet e subjektit të rivlerësimit

8. Përkundër sa Komisioneri Publik parashtron, subjekti i rivlerësimit në seancë dëgjimore publike ka prapësuar se janë deformuar faktet, duke u shkelur parimet themelore të një procesi të drejtë dhe objektiv. Sipas subjektit të rivlerësimit, vlera e pasurisë së tij dhe e shpenzimeve të kryera ndër vite është më e vogël se shuma e siguruar nga burimi i ligjshëm i të ardhurave, pra nuk rezultojnë të jetë sa dyfishi i saj, siç e parashikon Kushtetuta që mund të përbëjë shkak për shkarkimin e tij nga detyra. Sipas subjektit të rivlerësimit, nga përlogaritja analitike e të gjitha burimeve të të ardhurave të tij dhe të bashkëshortes së tij, të realizuara ndër vite, sipas të dhënave që disponon ILDKPKI-ja dhe nga përmbajtja e dokumenteve të administruara nga Komisioni, ku përfshihen të ardhurat, kredia dhe huatë, shuma është e barabartë me 51 437 924 400 lekë. Duke i zbritur kësaj shume shpenzimet e jetesës, shpenzimet e tjera të kryera dhe vlerën e pasurisë që ka blerë ndër vite, prej 39 012 020 lekësh, sipas metodikës së ILDKPKI-së, rezultojnë që në buxhetin familjar duhet të jetë një mbetje e akumuluar prej 12 425 804 000 lekësh dhe, sipas këtyre shifrave, duhet të ketë gjendje një shumë parash dhe jo të mos mbulojë pasurinë që disponon. E gjithë pasuria e vënë gjatë viteve të punës, sipas subjektit të rivlerësimit, përbëhet nga një apartament banimi 98 m² dhe një makinë e vitit 2006, pasi apartamenti tjetër ku jeton është pasuri e BKT-së deri në vitin 2033, kohë kur duhet të shlyhet kredia e marrë. Nëse nuk ka indicie apo prova, sipas subjektit të rivlerësimit, që një pasaktësi në deklarin e të dhënave të pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, të jetë produkt i ndonjë veprimtarie korruptive apo kriminale nga ana e subjektit, atëherë Komisioni dhe Kolegji i Apelit kanë diskrecion sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, që të vlerësojnë përfundimisht nëse subjekti i rivlerësimit ka besueshmëri për t’u konfirmuar në detyrë, sipas bindjes së tyre të brendshme pa u ndikuar nga asnjë rrethanë tjetër.
- 8.1. Për pasurinë e llojit “apartament”, me sipërfaqe 98 m², me adresë në rrugën {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit sqaron se vëllai i tij ka qenë emigrant i palegalizuar në Greqi dhe gjatë kësaj periudhe ka siguruar të ardhura të konsiderueshme; është e kuptueshme që vëllai nuk ka pasur ndonjë detyrim për të deklaruar të ardhurat e realizuara në Greqi dhe, rrjedhimisht, këto të ardhura të realizuara nga vëllai nuk konsiderohen si të ardhura të paligjshme, pasi janë produkt i punës dhe djersës së tij dhe, për pasojë, kjo nuk përbën shkelje të asnjë dispozite të legjislacionit tonë; kur është bërë kontrata e porosisë në vitin 1997, subjekti i rivlerësimit dhe i vëllai, M.D., kanë rënë dakord që të blihej kjo banesë, duke përfshirë të gjitha të ardhurat e familjes; më pas, në vitin 1998 vëllai u legalizua në Greqi dhe në vitin 1999 u martua duke krijuar familjen e tij, prandaj nuk pati interes më për të kontribuar më tej për këtë banesë; është fakt i njohur gjerësisht se, përveç punësimit si gjyqtar, subjekti i rivlerësimit ka qenë i angazhuar me mësimdhënie në fakultete të ndryshme, komisione, borde të ndryshme, por për një pjesë të tyre nuk ekzistojnë dokumente, pasi ato nuk ruheshin prej tij, por nga institucionet përkatëse shtetërore, dhe aktualisht ato nuk i disponon. Lidhur me faktin e mungesës së dokumentacionit për disa periudha punësimi të tij përpara vitit 1997, subjekti i rivlerësimit sqaron se nuk ekzistojnë të derdhura kontributet nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, mungojnë të dhënat mbi pagën për periudhën tetor - dhjetor 1993, për periudhën maj - dhjetor 1994, por punësimi i tij provohet nga vendimet gjyqësore që ka dhënë në atë periudhë dhe nga librezat e punës dhe vendimi i KLD-së për emërimin e tij; për

periudhën gusht - tetor 1993 ka punuar si jurist pranë Ministrisë së Punës dhe Emigracionit dhe të Përndjekurve Politikë, për periudhën 1988-1989 ka qenë i punësuar në Ndërmarrjen Gjeologjike Mat Bater të Martaneshit.

- 8.2. Për pasurinë e llojit “apartament”, me sipërfaqe 146 m² dhe garazh me sipërfaqe 15,25 m², me adresë në rrugën {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit sqaron se deklarata noteriale nga ana e vjehrrit për saktësimin e momentit të dorëzimit të parave me një deklaratë noteriale të mëvonshme, nuk mund të interpretohen në asnjë rast si deklarime të pasakta; qëllimin e deklaratës noteriale nuk mund ta interpretojë askush tjetër, përveç palëve që janë nënshkruese të saj dhe gjykatës, pasi vetëm ato e vërtetojnë qëllimin për të cilin kanë rënë dakord, gjithçka tjetër që komentohet rreth këtyre akteve, është keqinterpretim. Ai gjithashtu sqaron se në rend kronologjik, të ardhurat e kunatit sipas viteve janë: viti 2010: pagë neto 8855,3 euro, viti 2011: pagë neto 8936 euro, viti 2012: pagë bruto 11450 euro, viti 2013: pagë bruto 12753,51 euro, viti 2014: pagë bruto 6541,23 euro. Kunati nga viti 2002 e në vazhdim jeton e punon në Itali, por për një periudhë ai nuk ka pasur dokumente të rregullta qëndrimi, për pasojë nuk ka mundur të sigurojë dokumente të rregullta punësimi, por është paguar me para në dorë për punën që ka kryer, fakt për të cilin nuk disponon asnjë dokument. Gjithashtu, edhe pasi është pajisur me leje qëndrimi në Itali, disa punëdhënës për interesat e tyre kanë vazhduar ta paguajnë kunatin pjesërisht me para në dorë dhe pjesërisht nëpërmjet pagesave bankare. Kjo do të thotë që dhe vërtetimet e të ardhurave të nxjerra nga organet tatimore pasqyrojnë një vlerë më të vogël se ajo që ka qenë reale.

Në lidhje me kredinë që Komisioneri Publik ka parashtruar, të cilën e ka marrë vëllai i subjektit të rivlerësimit, i cili për rrjedhojë nuk ka pasur mundësi t’i japë para borxh subjektit të rivlerësimit, ky i fundit prapëson se është një deklaram i pambështetur në prova dhe në ligj. Vëllai i tij ka pasur bilanc të ardhurash që të blejë pasuri të tjera shumëfish më të mëdha se ato që ka blerë. Sipas vërtetimit të lëshuar nën betim nga punëdhënësi, shtetasi grek E.V., M.D., nga data 1.3.1998 deri më datë 31.12.2001 ka marrë si pagë mujore 733 euro, 3 vjet e 9 muaj = 33.718 euro; nga viti 2001 deri në vitin 2013 ka përfituar pagë mujore 850 euro në muaj; 16 vite pune = 122.400 euro; nga data 1.6.2003 deri në vitin 2013, bashkëshortja ka përfituar pagë 850 euro në muaj = 103.700 euro; nga puna që ka kryer në bujqësi në shartimin e pemëve frutore së bashku me bashkëshorten kanë përfituar 9000 euro në vit; 15 vite pune = 135.000 euro. Sipas shpjegimeve dhe të dhënave që përmbajnë provat e administruara rezulton se vëllai dhe bashkëshortja e tij kanë punuar dhe në punë të ndryshme sezonale, si: vjelje dhe përpunim agrumesh, nga të cilat kanë nxjerrë të ardhura të konsiderueshme.

- 8.3. Për pasurinë apartament, me sipërfaqe 60 m², në Golem, Kavajë, në pronësi të vëllait të tij, L.D., subjekti i rivlerësimit sqaron se në deklaratën *vetting* nuk ka deklaruar se ka një apartament në përdorim, shtëpinë e të vëllait, për shkak të kuptimit ndryshe që ka për marrëdhënien juridike të përdorimit të sendit; pagesa e energjisë elektrike për llogari të një subjekti tjetër, që në këtë rast është vëllai i subjektit të rivlerësimit, nuk vërteton përdorimin e banesës. Ky veprim i kryer nga ana e subjektit të rivlerësimit mund të klasifikohet si një kontratë porosie e parashikuar nga neni 913 i Kodit Civil. Pagesa e energjisë elektrike nga ana e tij për llogari të të vëllait nuk mund të

shërbejë si fakt për të vërtetuar se kjo pasuri i përket atij e jo vëllait të tij. Apartamenti është blerë nga i vëllai në vitin 2003 me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.9.2003, me një çmim 1.900.000 lekë. Për blerjen e kësaj pasurie kanë kontribuar të dy vëllezërit së bashku, L.D. dhe M.D. Nga verifikimet e dokumentacionit dhe nga përlllogaritjet e bazuara në të dhënat statistikore dhe diskutime me ekspertë të fushës, rezulton se deri në vitin 2003, familja e L.D. ka pasur burime të ardhurash nga paga dhe nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral në shumën 5,1 milionë lekë. Pra, diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve rezulton të jetë 2.240.000 lekë.

- 8.4. Për likuiditetet, në lidhje me diferencat e pambuluara për vitet 2011, 2012, 2014, subjekti i rivlerësimit sqaron se është një fakt i panjohur më parë prej tij, pasi gjatë hetimit administrativ nuk është konstatuar një fakt i tillë dhe, për pasojë, nuk i është ngarkuar barra e provës në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit D të Kushtetutës.
- 8.5. Subjekti i rivlerësimit kërkoi marrjen në cilësinë e provës së re: i) deklaratën noteriale të M.D., nr. rep. {***}, nr. {***} kol., datë 6.12.2018, për të plotësuar pretendimet që të ardhurat e M.D. kanë qenë të mjaftueshme, madje disa herë i kalojnë shpenzimet, përfshirë dhe huan që i ka dhënë subjektit të rivlerësimit; ii) shkresën e Gjykatës Kushtetuese nr. {***} prot., datë 11.12.2018, me të cilën vërteton se ai në këto udhëtime (jashtë shtetit) ka qenë si përfaqësues i Gjykatës Kushtetuese, si dhe tabelën e shpenzimeve që e shoqëron atë; iii) dy materiale të nxjerra nga interneti, prej të cilëve i pari është ankimi që ka bërë Komisioneri Publik për një subjekt tjetër që do të shqyrtohet në Kolegjin e Apelit, kurse i dyti është marrë nga një mbledhje në të cilën Komisioneri Publik ka qenë kandidat për në Gjykatën e Strasburgut, kur subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Kandidaturave, komision që ka skualifikuar kandidaturën e Komisionerit Publik, për të cilën edhe subjekti i rivlerësimit ka votuar kundër.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

9. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Apelit është shtrirë në drejtim të shqyrtimit të vendimit të Komisionit vetëm për çështjet faktike dhe ligjore, që janë të rëndësishme për dhënien e vendimit, si dhe në drejtim të konstatimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes, të respektimit të ligjit procedural dhe zbatimit të ligjit material për secilin prej shkaqeve të ankimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin F të Aneksit Kushtetues, nenin 5, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

A. Të përgjithshme

10. Çështja e paraqitur i përket Juridiksionit të Rivlerësimit, kompetent për shqyrtimin e së cilës është Kolegji i Apelit. Juridiksioni i Rivlerësimit dhe kompetencat e institucioneve të ngritura posaçërisht bazohen në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, sipas së cilës: “Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese”, si dhe në nenin 5, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave: “1). Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji

i Apelimit, komisionerët publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë. 2). Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit dhe ka mandat 9-vjeçar”.

11. Trupi gjykues, në seancë publike, datë 12.12.2018, u njoh me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e akteve shtesë në cilësinë e provës. Në lidhje me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e këtyre provave¹, në përputhje me nenin 49, paragrafi 6, germa “a”, trupi gjykues vendosi se këto prova janë të panevojshme dhe refuzoi marrjen e tyre, si dhe urdhëroi kthimin te subjekti i rivlerësimit.
12. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara nga nenet 47, 48/1, 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim ligji nr. 49/2012). Në bazë të nenit 48, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, aspektet e legjitimitimit formal të ankimit janë kompetencë e Komisionit, i cili dërgon ankimin, së bashku me: i) vendimin për pranimin e ankimit; ii) aktet e komunikimit të ankimit; dhe iii) dosjen e gjykimin.
- 12.1. Përcaktues për formën e gjykimin, në seancë publike në Kolegji, është cilësia e subjektit ankues që ka vënë në lëvizje procedurën e ankimit. Bazuar në pikën 3 të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, në rastin e ankimit nga Komisioneri Publik, Kolegji i Apelimit e gjykon çështjen në seancë publike.

B. Legjitimi formal

13. Kushtet dhe procedurat për pranimin e ankimit burojnë me referim nga ligji nr. 84/2016 te ligji nr. 49/2012, përcaktimet e të cilit plotësohen edhe nga Kodi i Procedurës Civile. Neni referues 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, përcakton: “Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji”. Në vijim neni 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i cili plotëson dispozitat e gjykimin administrativ, përcakton: “Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe”.
14. Për sa i përket legjitimitimit kohor, Komisioneri Publik legjitimohet, bazuar në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apeliimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit”.
15. Për sa i përket legjitimitimit personal, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, përcakton: “Ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojnë ankim pranë këtij Kolegji subjekti i rivlerësimit dhe

¹ Dokumentet të cilat u kërkuan që të merren në cilësinë e provës nga subjekti i rivlerësimit janë ato të cituara në paragrafin 8.5 të këtij vendimi.

Komisioneri Publik, sipas ligjit, me përjashtim të vendimeve të marra sipas nenit E, paragrafi 2, të Aneksit 2”, kurse neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përcakton: “Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelineve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.” Rezulton se ankimi është paraqitur nga Komisioneri Publik Darjel Sina.

16. Vendimi i Komisionit është i ankimueshëm dhe nuk bën pjesë në përjashtimin e nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, i cili referon në nenin E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Duke vijuar me shkaqet formale të pranimit të ankimit, nuk rezulton që të ketë heqje dorë nga ankimi, ankimi është paraqitur në aq kopje në numër sa janë personat që marrin pjesë në çështje si palë, është nënshkruar rregullisht, tregohen palët ndërgjyqëse, është i përcaktuar vendimi kundër të cilit bëhet ankim dhe se çfarë kërkohet me ankimin dhe, në përmbyllje, ankimi i paraqitur plotëson kushtet e pranueshmërisë për shqyrtim nga Kolegji i Apelimit.

C. Objekti i procesit të rivlerësimit

17. Procesi i rivlerësimit, bazuar në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, ka për qëllim që të garantojë funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthejë besimin e publikut tek institucionet e këtij sistemi.
18. Në rastin konkret, procesi i rivlerësimit është bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton se vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve ose në vlerësimin tërësor të procedurave.

Ç. Në lidhje me shkaqet ankimore

19. Në përputhje me përcaktimet ligjore për arritjen e qëllimit të procesit të rivlerësimit, për çështjen në gjykim, trupi gjykues i Kolegjit të Apelimit shqyrton vendimin objekt ankimimi, në rastin konkret, në themel vlerësoi kontrollin e kriterit të pasurisë.

D. Vlerësimi i pasurive

20. Subjekti i rivlerësimit, më datë 31.1.2017, brenda afatit ligjor, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (*vetting*) pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe të Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), në vijim të të cilit është përgatitur akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, me funksion gjyqtar dhe Kryetar në Gjykatën Kushtetuese.
21. Trupi gjykues i Kolegjit të Apelimit, pasi shqyrtoi konstatimet dhe vlerësimet e Komisionit, arrin në përfundime të ndryshme nga Komisioni, lidhur me kriterin e pasurisë.

22. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për justifikimin e të ardhurave nga huat e dhëna nga personat e tjerë të lidhur, bazuar në remitancat që emigrantët shqiptarë kanë sjellë në familjet e tyre, nga të cilat pretendon se ka përfituar dhe ai vetë, trupi gjykues vëren se remitancat tregojnë se ka pasur flukse parash, të cilat kanë hyrë dhe vazhdojnë të hyjnë në Shqipëri, por ato nuk janë provë në këtë gjykim. Trupi gjykues ka parasysh që remitancat jo gjithmonë tregojnë se janë të ardhura të ligjshme në bazë të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me pasurinë me sipërfaqe 98 m² dhe sipërfaqe 146 m² në pronësi të tij, blerë sipas tij edhe me kontribute të pjeshme nga të ardhurat e të vëllait M.D. dhe kunatit E.C., theksoi se duhet të konsideroheshin si të ligjshme, duke qenë se për të remitancat janë një fakt i njohur botërisht. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave të dhëna hua. Trupi gjykues vëren se argumenti i subjektit të rivlerësimit bie ndesh me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 21 të udhëzimit të ILDKPKI-së nr. 4095, datë 10.10.2016. Këto akte ligjore dhe nënligjore kërkojnë nga subjektet e rivlerësimit dhe nga institucionet e rivlerësimit që për të ardhurat e deklaruara, subjektet e rivlerësimit, persona të lidhur ose persona të tjerë të lidhur me ta, kur këta të fundit janë në kushtet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të provojnë me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave dhe pagimin e detyrimeve tatimore për to. Përveç sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se që ato të konsiderohen të ligjshme, duhet provuar edhe mënyra se si ato kanë mbërritur te subjekti i rivlerësimit.
- 22.1. Trupi gjykues i Kolegjit të Apelimit vlerëson që pavarësisht se njihen botërisht prurjet e emigrantëve në ekonominë shqiptare në formën e remitancave, të njohura edhe nëpërmjet akteve publike, ato mund të merren në konsideratë në gjykim nëse ka prova të mjaftueshme, të cilat plotësojnë kushtet e cituara në paragrafin 22 të këtij vendimi.
23. Shkaqet e ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik për kontrollin e vlerësimit të pasurisë renditen të ndara për secilën pasuri nominalisht dhe, në përmbajtje, lidhen me kundërshtimin e konstatimit të fakteve dhe të arsytimit ligjor të Komisionit, në drejtim të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive, të saktësisë së deklaramit nga subjekti i rivlerësimit, duke përfshirë edhe kontrollin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive nga personat e lidhur dhe personat e tjerë të lidhur.
24. Kundërshtimi i Komisionerit Publik për justifikimin e pronësisë të subjektit të rivlerësimit Bashkim Dedja, mbi pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 98 m², ndodhur në Tiranë, në Njësinë Bashkiake Nr. {***}, rruga {***}, pll. {***}, shk. {***}, ap. {***}, përqendrohet te mungesa e aftësisë paguese për këstin e parë, por edhe për pagimin e kësteve të tjera në vitin 1997, pra për burimin e ligjshëm të të gjithë çmimit prej 19.600 USD.
- 24.1. Trupi gjykues, në lidhje me shkakun e sipërcituar të ankimit vëren se, bazuar në kontratën e sipërmarrjes, me nënshkrimin e saj, pronari duhet t'i paguante sipërmarrësit në Bankën e Kursimeve paradhënie 30% të apartamentit të preventivuar me shumën 588.000 lekë, ndërkohë që me arritjen e punimeve në katin e katërt, pronari ishte i detyruar të paguante 30% të vlerës së

preventivit në shumën 5880 USD. Me fillimin e punimeve të rifiniturës, pronari duhet t'i paguante sipërmarrësit edhe 30% të vlerës së preventivit në shumën 5880 USD, ndërsa pjesa e mbetur nga shuma totale e preventivit prej 10%, në shumën 1960 USD, do të likuidohet kur të dorëzoheshin "çelësat në dorë". Në mungesë të dëftesave të pagesës për të vërtetuar shlyerjen, në analizën e kryer nga trupi gjykues i Kolegjit të Apelit, shërbejnë faktet prezumuese të kryerjes së këtyre pagesave, sikurse vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. {***}, datë 14.11.1997 dhe procesverbali i kolaudimit nr. {***}, datë 13.7.1997. Kryerja në tërësi e pagesave pohohet nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe konfirmohet edhe nga shoqëria ndërtuese.

24.2. Subjekti i rivlerësimit, i vetëm, nuk ka justifikuar ligjërisht burimet financiare për të fituar këtë pasuri. Paaftësia paguese e subjektit të rivlerësimit qëndron që në pagimin e vetë kështit të parë, duke ngritur pamundësinë e justifikimit të burimit për të paguar të gjitha kështet. Nga analiza financiare, e kryer nga trupi gjykues, u arrit në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, për pagimin e kështit të parë, kishte një diferencë të pambuluar me të ardhura të ligjshme në shumën prej 68.117 lekësh.

24.3. Në shënimet e librezës së punës konstatohet se subjekti ka qenë i punësuar në Ministrinë e Çështjeve Sociale dhe Gruas, periudhë për të cilën nuk është paraqitur ndonjë dokument shkresor për të ardhurat e krijuara, sipas të dhënave të mëposhtme: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas – specialist; periudha: 16 gusht 1993 - 19 tetor 1993 (2 muaj); shkak i largimit nga puna: "Larguar nga detyra dhe ndryshim vendi". Meqenëse për këtë periudhë punësimi nuk posedohen dokumente për të ardhurat e përfituara nga subjekti, për efekt të përlllogaritjes kemi marrë në konsideratë pagat referuese të publikuara në faqen e Institutit të Sigurimeve Shoqërore para vitit 1994 në: www.iss.gov.al/wp-content/uploads/2014/02/Pagat_Referuese_para_1994. Për pozicionin e specialistit në Ministri dhe institucione të tjera shtetërore, trupi gjykues u bazua në pagën referuese prej 4.384 lekësh/muaj dhe kemi përlllogaritur: 2 muaj \times 4.384 lekë = 8.768 lekë.

24.4. Si dokumentacion provues, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën nr. {***}, datë 16.04.2018, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Drejtoria e Administratës dhe Financës në të cilën vërtetohet se Bashkim Dedja, bazuar në dokumentacion e ndodhur në dosjen e tij personale që disponon Sektori i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, *me vendimin nr. {***}, datë 20.10.1993 të KLD, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë*. Vërtetimi i marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor vërteton të ardhurat e gjyqtarit duke filluar nga janari 1994, por nëse do të marrim në konsideratë datën e vendimit të KLD-së, përlllogaritja e pagave do të ishte duke filluar nga 20 tetori i vitit 1993. Të dhënat e marra në faqen e Institutit të Sigurimeve Shoqërore në lidhje me pagat referuese para vitit 1994 (burimi: www.iss.gov.al/wp-content/uploads/2014/02/Pagat_Referuese_para_1994), janë në formë tabele dhe, meqenëse aty nuk ka pagë referuese për pozicionin e gjyqtarit, është marrë paga referuese për pozicionin e specialistit në ministri dhe institucione të tjera shtetërore në masën prej 4.384 lekësh (2,3 muaj \times 4.384 lekë = 10.083 lekë). Në vërtetimin e lëshuar nga KLD-ja, me shkresën nr. {***}, datë 16.04.2018, nuk specifikohet që subjekti ka shërbyer si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Tiranë me shkëputje dhe, në të tilla kushte, trupi gjykues i ka t'i përlllogaritur subjektit pagën edhe për periudhën që gjykata nuk ka plotësuar të dhënat.

- 24.5. Metodologjia për llogaritjen e pagës për periudhën prill 1994 - dhjetor 1994, është bazuar në mesataren e muajit prill 1994, janar 1995 dhe shkurt 1995, sipas të dhënave në vërtetimin e lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë $(12.222 + 14.960 + 15.196)/3 = 14.126$ lekë $\times 8$ muaj = 113.008 lekë). Sipas vërtetimeve të pagave të sjella nga vetë subjekti dhe të përlllogaritjeve të mësipërme, është bërë analiza ekonomiko-financiare, e cila përfshin edhe vlerën e tri kësteve të paguara për apartamentin e banimit, si dhe koston e jetesës deri në fund të vitit 1997.
- 24.6. Lidhur me arsyetimin e Komisionit për vlerën provuese të shkresës me datë 16.04.2018 të shoqërisë “{***}” SHPK, për shlyerjen e detyrimeve të pagimit të kësteve të kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 473 të Kodit Civil, trupi gjykues i Kolegjit të Apelimit vlerëson se ky konfirmim shkresor i një kreditori, i vetëm, nuk mund në vetvete të çlirojë subjektin e rivlerësimit nga detyrimi për të provuar ekzekutimin e këtij detyrimi. Për të provuar shlyerjen e këtyre detyrimeve, Komisioni duhet të vlerësonte këtë shkresë të shoqërisë “{***}” SHPK në harmoni me prova të tjera shkresore për këtë qëllim.
- 24.7. Pas zbritjes së tri kësteve të pagesës për apartamentin e banimit, si dhe të koston të jetesës për periudhën referuese, sipas nivelit të dhënë në paragrafin 24.9 të këtij vendimi, subjekti rezultoi me shpenzime të pambuluara për këtë pasuri në masën 1.035.652 lekë.
- 24.8. Në lidhje me personin e lidhur, vëllanë M.D., trupi gjykues i Kolegjit të Apelimit konstaton se nuk ka rezultuar e provuar pjesëmarrja fillestare me 50% mbi këtë pasuri, me një akt krijues (kontratë), dhe as heqja dorë e mëpasshme nga kjo pasuri në kuptim të ligjit, që të ligjërojë bashkëpronësinë me subjektin e rivlerësimit. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk kanë arritur nivelin e provueshmërisë së ekzistencës së bashkëpronësisë së fituar me kontratë, si një prej mënyrave të fitimit të pronësisë në bazë të Kodit Civil, as edhe të përmbushjes së detyrimeve monetare që rrjedhin nga kontrata e pretenduar si e lidhur. Nuk rezultojnë të provuara nga asnjë akt shkresor apo më gjerë as edhe pagesat e pretenduara si të kryera në formën e kontributit për këtë pasuri nga personi i lidhur, M.D. Zoti M.D., në momentin e krijimit të kësaj pasurie, konfirmohet si person i lidhur, në kuptim të nenit 3, pika 13, si dhe të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/20176, si i përfshirë në certifikatën familjare me subjektin e rivlerësimit, fakt i pohuar edhe nga ky i fundit, si dhe i përfshirë në deklaratën vjetore të vitit 2003. Nga vërtetimi i Administratës së Centralizuar të Epirit - Maqedonia Perëndimore, Drejtoria e Përgjithshme e Funkcionimit të Brendshëm, Drejtoria e të Huajve dhe Emigracionit, Sektori i Lejeve të Qëndrimit Artë, për periudhën kohore të qëndrimit të ligjshëm, rezultoi se shtetasi shqiptar M.D. është mbajtës i lejes së qëndrimit nga viti 2002, ndërkohë që nga vërtetimi i regjistrimit të shtetasit të huaj, M.D., rezultoi se ai ka qenë i regjistruar në Regjistrin e Organizmit OAED - {***}, nga viti 1998, dhe i është lëshuar karta jeshile nga viti 1999, pra, pas vitit 1997. Vërtetimi i Njesisë Administrative Luzni, Bashkia Dibër, me anë të të cilit vërtetohet se M.D. ishte banor i Njesisë Administrative Luzni dhe nga vitit 1993 e në vazhdim ka qëndruar dhe ka punuar si emigrant në Greqi, vendi {***}, përveçse nuk plotëson kushtet e

formës, nuk është dokument provues në kuptim të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

24.9. Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit në seancë për mosllogaritjen e të ardhurave të tij për periudhat: i) 16.8.1993 - 19.10.1993, për shumën (pagë) e pretenduar të paguar nga Ministria e Punës, Emigracionit dhe të Përndjekurve Politikë (Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas) në vlerën 18.000 lekë, nga analiza financiare e të dhënave të librezës së punës, rezulton një vlerë prej 8.768 lekësh, e llogaritur me bazë pagën referuese për 2,3 muaj dhe jo për tre muaj sikurse pretendohet; ii) 20.10.1993 - 31.12.1993; për shumën (pagë) e pretenduar të paguar nga Gjykata e Rrethit Tiranë në vlerën 18.000 lekë, nga analiza financiare e vendimit nr. {***}, datë 20.10.1993 të KLD-së, rezulton vlera prej 10.083 lekësh, për 2,3 muaj dhe jo tre muaj sikurse pretendohet; iii) maj 1994 - 31.12.1994, për shumën (pagë) e pretenduar, të paguar nga Gjykata e Rrethit Tiranë në vlerën 104.000 lekë, nga analiza financiare rezulton shuma prej 113.008 lekësh, për tetë muaj, e llogaritur kjo me bazë pagën mesatare të vetë subjektit në vitin 1994; iv) 1.01.1988 - 31.12.1989, për sa i përket pagës që subjekti i rivlerësimit pretendon të ketë marrë gjatë dy viteve punë në Ndërmarrjen Gjeologjike Mat, Batër, Martanesh, në bazë të pagës referuese dhe analizës financiare të librezës së punës, trupit gjykues të Kolegjit të Apelit i rezulton vlera prej 100.608 lekësh. Duke marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe periudhat e pretenduara si të pallogaritura, duke përfshirë edhe koston e jetesës, jo më shumë se 30% të të ardhurave² të subjektit të rivlerësimit deri në muajin janar 1997, kohë që përkon me shlyerjen e këstit të parë, rezulton që ka një diferencë të pambuluar në shumën 68.117 lekë, sikurse ka diferencë të pambuluar edhe për pagesën e kësteve të tjera për këtë pasuri sipas afateve të përcaktuara në kontratë, në masën 1.035.652 lekë³.

24.10. Trupit gjykues të Kolegjit të Apelit për pasurinë e paluajtshme “apartament”, me sipërfaqe 98 m², i rezulton se subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, ka pasaktësi mes deklarimeve të deklaratës *vetting* dhe deklarimeve në deklaratën periodike vjetore të pasurisë 2003, ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të paguar vlerën e apartamentit dhe nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të personit të lidhur.

24.11. Sipas Komisionit, “Objekti i hetimit i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është kontrolli i pasurive të deklaruara gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të subjektit të rivlerësuar dhe jo kontrolli i deklaratave të pasurisë të bëra gjatë viteve, gjatë kryerjes së detyrës së parashikuar nga neni 179/b i Kushtetutës për subjektet e rivlerësimit [...]”⁴. Përkundrajt këtij arsyetimi të Komisionit, trupit gjykues i Kolegjit të Apelit vlerëson se pavarësisht se është e vërtetë që objekti

² Referenca në nivelin 30% është mbajtur në konsideratë për këtë vendim, duke qenë se ky ishte standardi i përllogaritjeve të Komisionit.

³ Vlerë që i korrespondon të paktën 50% të çmimit të kësaj pasurie.

⁴ Shiko faqen 9 të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 24, datë 13.06.2018.

i vlerësimit të pasurisë nga Komisioni është deklarimi i pasurive që i përkasin subjektit të rivlerësimit në momentin e deklaratës *vetting* (*ex nunc*), deklaratimet periodike duhet të merren në konsideratë si prova në këtë vlerësim, për shkak se ato mund të hedhin dritë mbi burimet e krijimit të pasurisë dhe në këtë mënyrë edhe mbi ligjshmërinë e pasurisë.

- 24.12. Komisioni ka theksuar se “[...] mospërfshirja e një burimi që ka ekzistuar më parë, por nuk ekziston më në momentin e deklarimit në formularin e *vetting*, i cili ka për objekt vetëm burimin e pasurive ekzistuese çmohet se nuk përbën shkak për fshehje të pasurisë apo deklarim të pasaktë në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë [...]”.⁵ Përkundrejt këtij arsytimi të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit të Apelit vlerëson se subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë në deklaratën *vetting* pasuritë e tij ekzistuese (*ex nunc*), por gjithashtu duhet të deklarojë në deklaratën *vetting* edhe burimin e të ardhurave të ligjshme në momentin e krijimit të pasurive “ekzistuese”. Fakti që vëllai M.D. nuk ishte më i interesuar për këtë pasuri pas vitit 1997 dhe u shlye për kontributin e vet sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, nuk ndryshon faktin që kontributi i vëllait në atë kohë ishte burim i krijimit të kësaj pasurie, i cili duhet të deklarojë në deklaratën *vetting*. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklarim të mjaftueshëm në deklaratën e pasurisë *vetting* (*ex tunc*), sipas përcaktimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
- 24.13. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit të Apelit vlerëson se pretendimi dhe kërkimi i Komisionerit Publik qëndron dhe, në këto kushte, subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, sipas kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
25. Kundërshtimi i Komisionerit Publik për mungesën e justifikimit të pasurisë apartament banimi, me sipërfaqe 146,14 m² dhe garazh me sipërfaqe 15,25 m², të ndodhur në Tiranë, Njësia nr. 5, rruga {***}, p. {***}, shk. {***}, ap. {***}, Tiranë me zk {***}, nr. pas. {***} dhe nr. {***}, lidhet me burimin e krijimit nga huamarrjet prej personave të tjerë të lidhur, vëllait M.D. dhe kunatit E.C. të subjektit të rivlerësimit.
- 25.1. Për huat e pretenduara, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktet në vijim: i) deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.3.2014, nga ku rezulton: “M.D. i ka dhënë më datë 22.8.2013 vëllait të tij, Bashkim Dedja, hua pa interes për një periudhë pa afat shumë prej 15000 (pesëmbëdhjetë mijë) eurosh”; ii) deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.3.2014, nga ku rezulton se: “E.C. i ka dhënë më datë 10.10.2013 kunatit të tij, Bashkim Dedja, hua pa interes për një periudhë pa afat shumë prej 10000 (dhjetë mijë) eurosh”; dhe iii) deklarata noteriale e vjehrrit të subjektit të rivlerësimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.4.2018, nga ku rezulton se: “Në muajin tetor të vitit 2013, pasi u konsultova me djalin tim E., i dhashë bashkëshortit të vajzës sime, Bashkim Dedja, shumë prej 10000 eurosh”. Deklaratat e para noteriale rezultojnë të dorëzuara paraprakisht me fillimin e procesit nga subjekti i rivlerësimit,

⁵ Shiko faqen 10 të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 24, datë 13.06.2018.

ndërkohë që deklarata noteriale e fundit është paraqitur në vijim të procesit, pasi rezultoi nga hetimet se në datën 26.3.2014, E.C. ka qenë në Shqipëri, pasi ka firmosur deklaratën përpara noterit, kurse në datën 10.10.2013, që ai ka përmendur në deklaratën e sipërcituar, nuk rezulton se ka qenë në Shqipëri. Në kundërshtim me argumentet e Komisionit për këtë çështje, trupi gjykues vlerëson se për të përcaktuar saktësinë dhe besueshmërinë e deklaratës *vetting* dhe shpjegimeve të dhëna pas kësaj deklarate për marrëdhëniet e huas që lidhen me burimin e krijimit të pasurisë, duhet që sigurisht të merren në konsideratë mënyrat në të cilat kryhen pagesat dhe mënyrat në të cilat ekzekutohen detyrimet.

25.2. Lidhur me shkakun e ankimit, në të cilin Komisioneri Publik kërkon që Kolegji i Apelit të vlerësojë nëse janë objekt i tatimit të ardhurat që rrjedhin nga huat, trupi gjykues i Kolegjit të Apelit vlerëson se Kushtetuta nuk e ka lënë në diskrecionin të organeve ligjzbatuese përcaktimin e të ardhurave “të tatueshme”, por ia ka njohur vetëm ligjit. Për këtë arsye, pjesa e shkëputur e fjalisë “të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e parashikuara në këtë nen” mund të gjejë zbatim vetëm brenda një norme pozitive ligjore, jo akti nënligjor dhe as diskrecional të organeve publike. Neni 155 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon se taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj. Trupi gjykues i Kolegjit të Apelit vlerëson se të ardhurat nga huaja barazohen me të ardhurat e përfituara nga interesi i huas, në rastin kur huaja është dhënë me interes nga institucionet financiare të licencuara, dhe në shumën e interesit të maturuar. Kur huaja është pa interes, nuk krijohen të ardhura dhe për rrjedhojë nuk aplikohet tatim.

25.3. Nga marrëveshja e huas pa interes, lind detyrimi i huamarrësit për kthimin e huas, por jo një e ardhur në kuptim të ligjit “Mbi tatimin mbi të ardhurat”, dhe as detyrim i individit/huamarrësit, subjekt rivlerësimi në këtë proces për të paguar tatim. Në rast konfirmimi të marrëdhënies së huas, në kontekstin e procesit të rivlerësimit, personi tjetër i lidhur detyrohet nga ligji nr. 84/2016 të justifikojë burimin e krijimit të pasurisë së dhënë hua.

25.4. Neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përcakton: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”. Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, përcakton: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.

25.5. Ligji nuk bën dallim për sa i përket detyrimit për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të personave të lidhur ose të personave të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse këta të fundit i konfirmojnë këto marrëdhënie. Duke qenë se personat e tjerë të lidhur, vëllai M.D. dhe kunati E.C., deklarohen si huadhënës që e konfirmojnë marrëdhënien e huas, ata do të trajtohen së bashku, brenda përcaktimit të nenit 32,

pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të rregullimit ligjor të kontratës së huas (konfirmimi i marrëdhënies së huas) dhe të ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave të dhëna hua.

- 25.6. Në kuptim të ligjit, huaja pa interes paraqitet si një marrëdhënie kontraktore, detyrimi monetar, sipas së cilës: i) huadhënësi i jep në pronësi huamarrësit një shumë të hollash; dhe ii) huamarrësi është i detyruar për t'i kthyer huadhënësit aq të holla, ose aq sende të atij lloji dhe të asaj cilësie, brenda afatit të caktuar në kontratë ose, kur nuk është caktuar afat, me kërkesën e huadhënësit. Kodi Civil, në pjesën e posaçme për kontratën e huas, nuk përcakton detyrim për formalizimin e kontratës. Nga ana tjetër, dispozitat urdhëruese ligjore për detyrimet monetare formalizojnë fazën e ekzekutimit të detyrimeve të ndërsjella sipas huas, vendin, datën dhe dëftesën e pagesës. Në kuptim të Kodit Civil, kontrata e huas është një kontratë tipike, joformale, që në rastin konkret në thelb ka ekzekutimin e detyrimeve monetare, ekzekutimi i të cilave, në mungesë të një përcaktimi të ndryshëm kontraktor, formalizohet me një shkresë, që i lëshohet diku për të vërtetuar se i është marrë diçka/para ose për të vërtetuar se ai ka paguar a ka dhënë diçka/para (dëftesë)⁶. Në këto kushte, kontrata e huas është kontratë joformale, por formale janë veprimet konkludente të përmbushjes së detyrimeve kontraktore. Sipas sa më sipër, në bazë të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, huadhënësit e vetëdeklaruar, M.D. dhe E.C., së bashku me subjektin e rivlerësimit, kishin detyrimin ligjor dhe kushtetues që gjatë procesit të rivlerësimit të justifikonin dhe të argumentonin me dokumente shoqëruese ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave, pjesë ato e çmimit të blerjes së apartamentit me sipërfaqe 146,14 m² dhe garazhit me sipërfaqe 15,25 m² në Tiranë.
- 25.7. Lidhur me arsyetimin e Komisionit për deklaratat noteriale të kunatit E.C dhe vjehrrit të subjektit të rivlerësimit P.C që “[...] sipas nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekt i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë të burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, dhe jo mënyra e kryerjes së pagesave dhe mënyra e ekzekutimit të detyrimit [...]”⁷, trupi gjykues i Kolegjit të Apelit vlerëson se mënyra në të cilën kryhen pagesat dhe shlyhen detyrimet duhet të merret në konsideratë për të përcaktuar saktësinë dhe besueshmërinë e deklaratës *vetting* dhe shpjegimet e dhëna pas saj. Mospërputhjet e deklaratave noteriale të sipërcituara me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe me gjetjet e Komisionit, trupi gjykues i çmon si fakte që vijnë në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
- 25.8. Për sa i përket detyrimit të personave të tjerë të lidhur, M.D. dhe E.C., për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të dhëna hua, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, vërehet se për huadhënësit, vëllanë M.D. dhe kunatin E.C., pretendohet që kanë krijuar të ardhura respektivisht në shtetin grek dhe në shtetin italian. Me të dy këto shtete, në drejtim të

⁶ Në çdo rast kjo dëftesë duhet të vlerësohet në harmoni me provat e tjera shkresore, sipas interpretimit të bërë në paragrafin 24.6 të këtij vendimi.

⁷ Shih faqen 13 të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 24, datë 13.06.2018.

ligjshmërisë së të ardhurave të realizuara në secilin prej tyre, shteti shqiptar ka nënshkruar marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë, për efekt të transferimit të kapitaleve në shtetet respektive.

25.9. Me ligjin nr. 8000, datë 21.9.1995, është ratifikuar “Konventa ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Greke për shmangien e tatimeve të dyfishta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin”. Neni 4, pika 1, me titull “Rezidenti”, përcakton: “Për qëllime të kësaj Konvente, termi rezidenti i një Shteti Kontraktues nënkupton çdo person që sipas ligjeve të atij Shteti është subjekt i tatimeve atje për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të drejtimit, vendit të regjistrimit apo çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme”. Neni 15, pika 1 me titull “Shërbimet personale të varura”, përcakton: “1 [...] pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga punësimi i tij do të taten vetëm në këtë shtet, përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër”. Me ligjin nr. 7934, datë 17.5.1995, është ratifikuar “Konventa ndërmjet qeverisë së Shqipërisë dhe qeverisë së Italisë për shmangien e tatimeve të dyfishta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal”. Neni 4, pika 1, me titull “Rezidenti”, përcakton: “Për qëllime të kësaj Konvente, termi rezident i një Shteti Kontraktues nënkupton çdo person që sipas ligjeve të atij Shteti, është subjekt i tatimeve atje për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të drejtimit, vendit të regjistrimit apo çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme.”. Neni 15, pika 1 me titull “Shërbimet personale të varuara”, përcakton: “1[...] pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga të qenurit i punësuar do të taten vetëm në këtë shtet, përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër”.

25.10. Në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurve të ligjshme të M.D., subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetimin nën betim, datë 16.2.2018, të shtetasit grek E.V., i cili deklaron të ardhurat e paguara prej tij në llogari të M.D. për periudhën kohore prej vitit 1998 e deri në datën e deklaratës dhe për bashkëshorten e tij, znj. V.D., e cila nga data 1.6.2003 është punësuar në kompaninë e tij të prodhimit të fidanëve, agrumeve, ullinjve, kivit, shëgëve dhe vreshtave. Pasi shqyrtoi këto deklarata, trupi gjykues i Kolegjit të Apelimit, bazuar në nenin 49, pika 5, vlerëson se të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit për punësimin e personit të lidhur, M.D., në Greqi, nuk plotësojnë kushtet për t’u konsideruar si pasuri të ligjshme; për qëllimet e këtij ligji, konsiderohen të ardhurat për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Deklarata noteriale në fjalë nuk përmban të dhëna për sa i përket pagimit të detyrimeve tatimore për periudhën kohore në fjalë. Nga vërtetimet e sipërcituara, të lëshuara nga organet publike greke, rezulton se M.D. është regjistruar në organizimin e punësimit të shtetit grek, është pajisur me leje pune më datë 21.6.1999 dhe është posedues i lejes së qëndrimit nga data 15.4.2002 deri në datën 3.9.2014. Trupi gjykues i Kolegjit të Apelimit, bazuar në nenin 49, pika 5, vlerëson se këto dokumente nuk përmbajnë të dhëna për pagimin e detyrimeve tatimore, por të dhëna për punësimin dhe qëndrimin e ligjshëm në shtetin grek.

25.11. Në lidhje me të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur E.C., nga analiza financiare, mbështetur në të dhënat e pasqyruara në vërtetimin e lëshuar nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore të Republikës Italiane, shuma neto prej 17.741,62 eurosh mund të konsiderohet si e ardhur me burim të ligjshëm, për të cilën janë shlyer edhe detyrimet tatimore në shtetin italian. Për pjesën tjetër të të ardhurave të pretenduara për periudhën 2010, 2011, 2012, 2013 në shumën prej

41.994,81 eurosh, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të konfirmojë pagesën e taksave dhe të detyrimeve tatimore kundrejt shtetit italian nga personi tjetër i lidhur E.C. dhe, si rrjedhojë, nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të pasurive në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Sipas kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Bazuar në këto kushte, rezulton se ka mungesë dokumentacioni zyrtar për të provuar të ardhurat dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore në vendin ku janë krijuar këto të ardhura. Trupi gjykues i Kolegjit të Apelimit, bazuar në nenin 49, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se dokumentet e paraqitura sa më sipër nuk plotësojnë kushtet për t'u konsideruar si pasuri të ligjshme, që sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

- 25.12. Në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare të zbatueshme, nuk rezulton se huadhënësit e subjektit të rivlerësimit, respektivisht, vëllai dhe kunati i tij, të kenë justifikuar ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së deklaruar të dhënë hua në favor të subjektit të rivlerësimit. Referuar aftësisë paguese të M.D. dhe E.C., rezulton se ka mungesë dokumentacioni justifikues për të provuar të ardhurat dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore në vendin ku janë krijuar këto të ardhura.
- 25.13. Në përmbyllje, trupit gjykues të Kolegjit të Apelimit për pasurinë e paluajtshme “apartament”, me sipërfaqe 146,14 m² dhe “garazh” me sipërfaqe 15,25 m², në Tiranë, i rezulton se personat e tjerë të lidhur, vëllai M.D. dhe kunati E.C., nuk kanë justifikuar ligjshmërinë e të ardhurave për huat e dhëna subjektit të rivlerësimit dhe, për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
26. Për sa i përket kundërshtimit të Komisionerit Publik për mungesën e deklarimit të përdorimit të pasurisë nr. {***}, apartament me sipërfaqe 60 m², vol. {***}, f. {***}, zk {***}, Golem, Kavajë, Kryemëdhenj, përdorim i provuar me shkresën nr. {***} prot., datë 30.1.2018, të OSHEE, nga ku rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kontratë furnizimi energjie elektrike me OSHEE, trupi gjykues vëren se ky shkak ankimi i Komisionerit Publik është i bazuar.
- 26.1. Neni D, pikat 1 dhe 5, respektivisht përcaktojnë: “1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur [...]” dhe “[...] 5. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.
- 26.2. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, bazuar në paragrafin 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, vëren se nga prova e administruar për të vërtetuar kontratën e subjektit të rivlerësimit me OSHEE-në, të lidhur nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2004, dhe nga shpjegimet që dëgjoji

nga ky i fundit me shkrim dhe me gojë në seancë, subjekti i rivlerësimit e ka përdorur këtë pasuri, të cilën nuk e ka deklaruar as në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (*vetting*) të vitit 2016 dhe as në deklaratat vjetore, por e ka pohuar gjatë shqyrtimit të çështjes nga Komisioni. Në aspektin procedural, neni 246 i Kodit të Procedurës Civile përcakton: “Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementet e nevojshme për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose të shuara, nuk kanë gërvishtje ose shtesa midis rreshtave, ose çrregullime të tjera me shuarje dhe mund të lexohen”. Sipas shkresës nr. {***}, datë 29.12.2017, të OSHEE-së dhe bazuar në vendimin nr. 17, datë 19.12.2001, të Këshillit Drejtues të ERE-s “Mbi miratimin e udhëzimit mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj”, konstatohet dhe çmohet se përdorues të energjisë elektrike janë personat fizikë dhe juridikë, zotërues të objektit, ku janë vendosur pajisje që punojnë me energji elektrike dhe janë apo duan të lidhen në rrjetin elektrik. Qëndrimet e subjektit të rivlerësimit për këtë marrëdhënie janë të ndryshme, të papajtueshme, në kundërshtim të hapur me faktet evidente në dosje, duke mohuar një fakt flagrant të ekzistencës së një marrëdhënieje kontraktuale midis subjektit të rivlerësimit dhe furnizuesit me energji elektrike OSHEE.

- 26.3. Si rrjedhojë e sa më sipër, në përfundim, trupit gjykues të Kolegjit të Apelimit i rezultoi se për përdorimin e pasurisë së paluajtshme “apartament”, me sipërfaqe 60 m², në Golem, Kavajë, subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaram në lidhje me përdorimin e kësaj pasurie, fakt ky që bie ndesh me nenin D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016.
27. Komisioneri Publik për pjesën e likuiditeteve, kundërshton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë si në vijim: i) në vitin 2010 me diferencë të pambuluar në shumën 21.318 lekë; ii) në vitin 2011 me diferencë të pambuluar në shumën 537.350 lekë; iii) në vitin 2012 me diferencë të pambuluar në shumën 85.197 lekë; iv) në vitin 2013 me diferencë të pambuluar në shumën 3.516.645 lekë; v) në vitin 2014 me diferencë të pambuluar në shumën 481.000 lekë; vi) në vitin 2015 me diferencë të pambuluar në shumën 97.251 lekë.
28. Pas analizës financiare, trupi gjykues i Kolegjit të Apelimit ka konstatuar sa më poshtë.
- 28.1. Analiza e likuiditeteve në Kolegj është kryer duke marrë në konsideratë:
- a) gjendjet në fillim të vitit në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes, bazuar në pasqyrat e lëvizjeve financiare;
 - b) paratë në dorë të mbledhura dhe të përdorura për shpenzimet e deklaruara;
 - c) të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, të vërtetuara nga institucionet përkatëse për pagat neto ndër vite;
 - ç) të ardhurat e siguruara nëpërmjet kredive bankare;
 - d) të ardhurat e krijuara si rezultat i shitjes së pasurive të luajtshme (automjet);
 - dh) pasuritë e shtuara apo të pakësuara të vitit përkatës (apartament, automjet);
 - e) likuiditete në para në dorë të deklaruara si kursime nga subjekti ndër vite;
 - ë) shpenzimet për shlyerjen e kësteve të kredisë;

- f) shpenzimet jetësore, bazuar në përlllogaritjet e kryera nga ILDKPKI-ja⁸;
- g) shpenzimet e deklaruar nga subjekti në deklarata periodike vjetore dhe sqarimet e dhëna para Komisionit në lidhje me shpenzimet (shkollimi i fëmijëve, udhëtimet, mobilime);
- gj) gjendjet në fund të vitit në llogarinë bankare të subjektit dhe bashkëshortes, bazuar në pasqyrat e lëvizjeve bankare.

Trupi gjykues i Kolegjit të Apelimit, në analizën financiare nuk ka marrë në konsideratë shumat e marra hua nga vëllai M.D. dhe kunati E.C.

- 28.2.** Sipas Komisionerit Publik, për vitin 2013, diferenca e pambuluar është (-) 3.516.645 lekë, ndërsa sipas analizës financiare të kryer nga trupi gjykues i Kolegjit të Apelimit, ky vit del me gjendje (+) 727.245 lekë. Kjo diferencë vjen për shkak se në vitin 2013, nga ana e Komisionerit Publik nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat “cash” të kursyera deri në fund të vitit 2012, të cilat sipas deklarimeve të subjektit rezultojnë në shumën 4.873.275 lekë dhe janë përdorur për shlyerjen e detyrimit ndaj shoqërisë së ndërtimit për blerjen e apartamentit. Nga ana tjetër, sipas analizës financiare të bërë nga trupi gjykues i Kolegjit të Apelimit, bazuar në dokumentacionin e administruar në proces, mundësia reale e kursimit e subjektit të rivlerësimit Bashkim Dedja për këto vite ka qenë më e vogël, pra në shumën 4.207.839 lekë. Trupi gjykues në analizën e tij ka vlerësuar faktin që subjekti për vitet 2011 dhe 2012 paraqitet me gjendje negative të balancës vjetore (respektivisht në vitin 2011 në vlerë (-) 525.794 lekë dhe në vitin 2012 në vlerë (-) 139.642 lekë), që do të thotë se subjekti nuk ka pasur aftësi financiare për të mbuluar shpenzimet me të ardhurat e ligjshme për këto vite. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit të Apelimit, bazuar në analizën financiare për periudhën 2010-2015, vëren se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për këto vite: i) për vitin 2011 në shumën 525.794 lekë; ii) për vitin 2012 në shumën 139.642 lekë; iii) për vitin 2014 në shumën 294.272 lekë; iv) për vitin 2015 në shumën 108.841 lekë, situatë faktike kjo që bie në kundërshtim me kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Në vendimin e shpallur publikisht, të arsyetuar në mënyrë të përmbledhur datë 17.12.2018, trupi gjykues në pikën 4.4 u është referuar viteve 2010, 2011, 2013, 2014, 2015. Ndërkohë, trupi gjykues çmon se për vitet 2011, 2012, 2014, 2015 subjekti rezulton se ka mungesë të burimeve financiare. Vitet 2010 dhe 2013 konstatohen të kenë qenë gabim në shkrim. Vlerat negative të burimeve financiare për secilin vit janë specifikuar në mënyrë të detajuar sa më sipër.
- 28.3.** Trupi gjykues vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit në seancën publike në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, se mungesa e likuiditeteve është një fakt i panjohur më parë prej tij dhe nuk i është kaluar barra e provës, është i pabazë. Subjekti në të njëjtën seancë propozoi të merren në cilësinë e provës tri dokumente të tjera nga trupi gjykues dhe iu referua një analize të tij financiare për likuiditetet. Duke qenë se njihej me pretendimet e Komisionerit Publik për vitet e pambuluara

⁸ Shpenzimet e jetësës për subjektin e rivlerësimit Bashkim Dedja janë bazuar në përlllogaritjet e ILDKPKI, duke qenë se analiza financiare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ishte bazuar në këto përlllogaritje.

- 2010, 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015 (shih tabelën 4, pika 2 e pjesës IV të ankimit), subjekti i rivlerësimit duhet të kishte paraqitur dokumente që do të provonin ekzistencën e likuiditeteve për vitet në fjalë. Në vlerësimin e situatës financiare të subjektit (shih paragrafin 28.2), lidhur me likuiditetet, trupi gjykues mori në konsideratë të gjitha dokumentet e parashtruara dhe vuri re që subjekti, përkundër pretendimit të tij, nuk ishte në gjendje të provonte bilanc pozitiv për likuiditetet siç është specifikuar konkretisht në paragrafin 28.2.”

Trupi gjykues arrin në përfundimet e mëposhtme.

29. Subjekti i rivlerësimit rezulton se ka në pronësi pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht dhe njëkohësisht nuk ka deklaruar plotësisht pasuritë në përdorim të tij. Për këtë arsye, nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë në përputhje me nenin 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
 - 29.1. Për pasurinë e paluajtshme “apartament”, me sipërfaqe 98 m², në Tiranë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi mes deklarimeve të deklaratës *vetting* dhe deklarimeve në deklaratën periodike vjetore të pasurisë 2003; ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të paguar vlerën e apartamentit; nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të personit të lidhur.
 - 29.2. Për pasurinë e paluajtshme “apartament” me sipërfaqe 146,14 m² dhe “garazh” me sipërfaqe 15,25 m², të ndodhur në Tiranë, rezulton se personat e tjerë të lidhur, E.C. dhe M.D. nuk kanë justifikuar ligjshmërinë e të ardhurave për huat e dhëna subjektit të rivlerësimit. Për këto arsye, subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie.
 - 29.3. Për përdorimin e pasurisë së paluajtshme “apartament”, me sipërfaqe 60 m², në Golem, Kavajë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklarinë në lidhje me përdorimin e kësaj pasurie.
 - 29.4. Lidhur me likuiditetet, për vitet 2011, 2012, 2014, 2015, sipas analizës së përshkruar në paragrafin 28.2, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme.
30. Trupi gjykues, në bazë të nenit 59, pika 1, germa “a” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, mbështetur në faktet e provuara në gjykim dhe në ligjin e zbatueshëm për çështjen,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 24, datë 13.6.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Bashkim Dedja, gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
U shpall në Tiranë, më datë 17.12.2018.

ANËTARE

Albana Shtylla
nënshkrimi

ANËTARE

Natasha Mulaj
nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta Schuetz
nënshkrimi

RELATOR

Luan Daci
Nënshkrimi

KRYESUES

Ardian Hajdari
nënshkrimi